



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Cn.nr.201/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Zenel Leku dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit N.T.P. “G. P.”, me seli në V., kundër debitorit F. G. –C.S.G.D, me seli në P., për shkak të propozimit për përmbarim, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lëndore midis Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, në Prishtinë, në seancën e kolegjit të mbajtur me 22.04.2024, mori këtë,

A K T V E N D I M

Për të vendosur në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore caktohet Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, të cilës, shkresat e lëndës i dërgohen në procedurë të mëtejshme.

A r s y e t i m i

Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin CP.nr.2725/16 dt.24.02.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, ndërsa, lënda i është dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës, si gjykatë kompetente për të proceduar në këtë çështje përmbarimore.

Gjykata Komerciale në Prishtinë me aktvendimin e vet KPPP.nr.1794/23 dt.26.03.2024, për të vendosur në këtë çështje juridike përmbarimore, ka hapur konfliktin e kompetencës midis Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm dhe Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, në Prishtinë, dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme, të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës bazuar në nenin 25.2 të LPK-së dhe nenin 13.7 të Ligjit Për Gjykatën Komerciale.

Në vështrim të nenit 13, par.1, pika 1.1, të Ligjit Për Gjykatën Komerciale, parashihet, veç tjerash se, Gjykata Komerciale ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështjet tjera mes tyre, përkatësisht, dhe pika 1.2 “ të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe duke vendosur përkitazi me konfliktin e kompetencës lëndore midis Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, në Prishtinë, në mbështetje të nenit të sipër përmendur, si dhe të nenit 12.1 dhe 20 të Ligjit për Gjykatat, nenit 5 të Ligjit Për Procedurën Përmbarimore, ka gjetur se kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike përmbarimore, është Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm. Kështu, për faktin se, në rastin konkret civil juridik - përmbarimor, midis ndërgjyqësve të lartë cekur, nuk kemi të bëjmë me raport afarist a çështje të ndërsjellë tregtare, por, me çështjen e përmbarimit, si në petitumin e propozimit për përmbarim të dt.12.09.2013.

Sa i përket dispozitës së nenit 13 par.1 nënp.2 të Ligjit Për Gjykatën Komerciale, lidhur me mjetet juridike, në të cilën thirret Gjykata Themelore në Prishtinë, duhet theksuar se mjetet juridike në procedurën përmbarimore janë përcaktuar shprehimisht me dispozitën e nenit 67 dhe nenit 68 të LPP-së, sipas të cilave rezulton se në procedurën përmbarimore, mjete të rregullta juridike janë Prapësimi dhe Ankesa, kurse, sa i përket mjeteve të jashtëzakonshme juridike, në të theksohet se nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarimore.

Mirëpo, kjo Gjykatë, ka gjetur se, në rastin konkret kemi të bëjmë me propozimin për përmbarim, pra, me zbatimin e përmbarimit të propozuar nga kreditori, dhe se çështja nuk ka të bëjë me shqyrtim sipas mjeteve juridike të parapara në procedurën përmbarimore, të sipër cekura (neni 67 dhe 68 i LPP), ndaj, as me kompetencën nga neni 13 i Ligjit Për Gjykatën Komerciale, nga këtu, rezulton se kompetente për të vendosur në këtë çështje përmbarimore dhe në pajtim me dispozitën e nenit 5 të LPP-së, është Gjykata Themelore në Prishtinë.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 25.2 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Cn.nr.201/2024 dt.22.04.2024

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha

